



Raporti Vjetor 2018



Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) është person juridik publik. Ajo është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. ASCAL, përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë, akreditimit dhe proceseve të tjera, monitoron dhe vlerëson cilësinë e institucionit dhe të programeve të ofruara. ASCAL mbështet veprimtarinë e saj mbi udhëzuesit e saj, standardet në arsimin e lartë dhe standardet dhe udhëzuesit europianë të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë.

Në zbatim të detyrimit ligjor për informimin e publikut si dhe për kryerjen e analizës së ecurisë së punës së saj gjatë vitit 2018, ASCAL harton raportin¹ analitik në të cilin paraqet në mënyrë të përmbledhur veprimtaritë kryesore. Ky aktivitet ka qënë i fokusuar në shumë drejtime si në përgatitjen e dokumentacionit ligjor në kuadër të implementimit të Ligjit 80/2015, në vlerësimin e programeve të reja të studimit, vlerësime në kuadrin e akreditimit, veprimtari të tjera me aktorë të arsimit të lartë dhe mjaft aktivitete të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Të gjitha këto informacione dhe të dhëna janë të publikuara në faqen zyrtare të ASCAL.

ASCAL

¹ Ky raport është dokument zyrtar i ASCAL dhe përmban informacione për të cilat ky institucion është përgjegjës. Në asnjë rast, nuk lejohet tjetërsimi apo keqpërdorimi i këtij informacioni për qëllime të tjera përveç informimit të publikut. Të interesuarit që kërkojnë të kenë këto informacione dhe t'i përdorin, ato për qëllimet e tyre, janë të lutur që zyrtarisht të kontaktojnë ASCAL.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

QUALITY ASSURANCE AGENCY FOR HIGHER EDUCATION

Adresa:

Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë, Shqipëri

Kontakt:

Drejtori (Tel/Fax) : 04 2 257954

Spektori i Promocionit dhe Vlerësimit (Tel/Fax): 04 2 266302

Spektori i Statistikave dhe Analizave (Tel/Fax): 04 2 243423

Spektori i Shërbimeve dhe Publikimit (Tel/Fax): 04 2 243423



E-Mail: info@ascal.al

website: www.ascal.al

Shkurtime dhe fjalori shpjegues

- **ASCAL** - Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë– Institucioni përgjegjës në Republikën e Shqipërisë për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe për akreditimin e institucioneve dhe programeve të studimit, në bazë të ligjit nr. 80/2015,
- **BA** – Bordi i Akreditimit– Organ kolegjal vendimarrës, i cili akrediton institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit, krijuar me ligjin nr. 80/2015,
- **MASH/ MASR** – Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Sportit dhe Rinisë– Ministria përgjegjëse për arsimin dhe sportin dhe rininë në Republikën e Shqipërisë
- **MPAL** – Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë
- **IAL** – Institucioni i arsimit të lartë – Institucione të arsimit të lartë janë: universitetet, shkollat e larta, kolegjet, akademitë dhe institutet
- **PS** – Program studimi – Programe të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë
- **Vlerësim** – Proces që ndjek ASCAL për të parë përputhshmërinë e një programi në kuadër të licencimit apo akreditimit. Vlerësimi mund të jetë teknik ose në përmbajtje, dhe bëhet me ekspertë të fushës
- **ENQA** – Rrjeti evropian i agjencive për sigurimin e cilësisë (European Network for Quality Assurance)
- **Akreditim** – procedurë vlerësimi e cilësisë në arsimin e lartë, që ndjek ASCAL bazuar në standardet shtetërore dhe ato europiane
- **LAL** – Ligji i arsimit të lartë
- **SSHC** – Standardet shtetërore të cilësisë janë dokumentet themelore që përmbajnë standarde dhe kritere minimale që duhet të përmbushë çdo institucion dhe program studimi për akreditimin e plotë.
- **SKS** – Sondazhi Kombëtar i Studentëve
- **ESG** – *European standards and guidelines* – Udhëzuesit dhe standardet europiane për sigurimin e cilësisë
- **CEENQA** – Central and Eastern European Network of Quality Assurance Agencies in Higher Education
- **Koordinator i IAL** – Person kontakti i caktuar nga IAL për komunikimin me ASCAL dhe shkëmbim informacioni nëpërmjet sistemit elektronik
- **KT** – koordinatori teknik – Përfaqësuesi i ASCAL që ndjek një proces të caktuar të aplikuar nga një IAL
- **EV** – Ekspert vlerësimi i njohur në një fushë të caktuar i angazhuar nga ASCAL për një proces vlerësimi
- **AMS** – ASCAL Management System - sistemi i menaxhimit elektronik i ASCAL
- **GVB** – Grupi i vlerësimit të brendshëm – personat e angazhuar nga IAL për realizimin e një procesi vetëvlerësimi të institucionit apo programit dhe raportit të vetëvlerësimit
- **GVJ** – Grupi i vlerësimit të jashtëm - Përgjegjës për realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm
- **DRVB** – Draftraport i vlerësimit të brendshëm – Raporti paraprak i GVB që i dorëzohet titullarit të IAL për miratimin e titullarit të IAL ose njësisë kryesore
- **RVB**–Raporti i vlerësimit të brendshëm
- **DRVJ** - Draftraport i vlerësimit të jashtëm – Raporti paraprak i GVJ që i dorëzohet ASCAL
- **RVJ** - Raporti i vlerësimit të jashtëm – Raporti i finalizuar nga GVJ
- **DPA** - Dosja e plotë e akreditimit – Dosja me dokumentacionin e plotë e përgatitur nga ASCAL për shqyrtim në BA (e printuar dhe në sistemin elektronik)
- **VBA** – Vendimi i Bordit të Akreditimit
- **VKM** – Vendim i Këshillit të Ministrave
- **UMA** – Urdhër i Ministrit të Arsimit

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT	5
KAPITULLI I.....	6
INSTITUCIONET E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË DHE FUNKSIONIMI I TYRE.....	6
1.1 ASCAL, MISIONI, OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET KRYESORE	6
1.2 BA, MISIONI, OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET KRYESORE	7
1.3 ORGANIZIMI, BAZA LIGJORE E FUNKSIONIMIT TË ASCAL/BA	8
1.4 EKSPERTËT E VLERËSIMIT TË JASHTËM	9
KAPITULLI II	11
VEPRIMTARITË KRYESORE TË ASCAL GJATË VITIT 2018.....	11
2.1 PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT LIGJOR DHE PROCEDURAL NË KUADËR TË PROCESVE TË VLERËSIMIT	11
2.2 AKREDITIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË DHE I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ..	14
2.3 LICENCIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT	26
2.4 SONDAZHI KOMBËTAR I STUDENTËVE, SKS.....	27
KAPITULLI III.....	30
SISTEMI I RUAJTJES DHE ADMINISTRIMIT TË INFORMACIONIT DHE PROCEDURAVE NË ASCAL.....	30
3.1 SISTEMI I MENAXHIMIT TË ASCAL, AMS	30
3.2 ADMINISTRIMI I PROCESVE TË VLERËSIMIT NËPËRMJET AMS DHE MONITORIMI I CILËSISË	32
3.3. INFORMIMI DHE PUBLIKIMI I INFORMACIONIT	35
3.4.SISTEMI I RUAJTJES, ARKIVIMIT TË INFORMACIONIT DHE I SHËRBIMEVE NË ASCAL.....	37
KAPITULLI IV.....	38
AKTIVITETE TË TJERA TË ZHVILLUARA NGA ASCAL DHE BA	38
4.1 AKTIVITETI I BORDIT TË AKREDITIMIT	38
4.2. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË OSE TË TJERA NË VEND	40
4.3. BASHKËPUNIMI I ASCAL ME RRJETET NDËRKOMBËTARE TË AGJENCIVE TË SIGURIMIT TË CILËSISË.....	43
4.4 AKTIVITETI FINANCIAR I ASCAL DHE BA, 2018.....	45
KAPITULLI V	53
PLANI I VEPRIMTARIVE PËR VITIN 2019	53

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

Nga miratimi i ligjit të arsimit të lartë 80/2015, sistemi arsimor në Shqipëri ka kaluar në disa zhvillime të rëndësishme. Fokusi kryesor i këtyre zhvillimeve ka qënë zbatimi i ligjit 80/2015 në institucionet e arsimit të lartë, riorganizimi i tyre dhe i programeve të studimit si dhe miratimi i akteve nënligjore në përputhje me këtë ligj. Këto zhvillime kanë prekur edhe institucionet publike të sigurimit të cilësisë (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, ASCAL dhe Bordi i Akreditimit, BA) të cilat jo vetëm janë bërë pjesë e zbatimit të kërkesave të ligjit por kanë ndërmarrë një sërë aktivitete në arsimin e lartë, akreditimin dhe sigurimin e cilësisë.

Disa nga drejtimet kryesore të këtyre zhvillimeve kanë qënë:

- Miratimi i akteve rregullatore dhe akteve të brendshme të ASCAL dhe BA;
- Angazhim në hartimin e standardeve shtetërore të cilësisë dhe përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm konform standardeve;
- Vlerësimi i programeve të studimit në kuadër të liçensimit apo akreditimit;
- Përgatitja e infrastrukturës logjistike dhe dokumentacionit të nevojshëm për realizimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS).

Të gjitha këto zhvillime si dhe aktivitete të tjera të ndërmarra gjatë vitit 2018 janë paraqitur në këtë raport vjetor. Raporti paraqet në mënyrë të përmbledhur dhe jep informacion të përgjithshëm në lidhje me këto zhvillime dhe është i bazuar në referenca dhe materiale të cilat janë publike dhe të aksesueshme.

Çdo e dhënë apo informacion i paraqitur në këtë raport mund të përdoret për qëllime informimi dhe studimi, por në asnjë rast nuk mund të keqpërdoren, tjetërsohen apo nxirren jashtë kontekstit për të cilin janë paraqitur.

ASCAL

KAPITULLI I

INSTITUCIONET E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË DHE FUNKSIONIMI I TYRE

1.1 ASCAL, MISIONI, OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET KRYESORE

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), është person juridik publik përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. ASCAL, përmes mekanizmave të sigurimit të jashtëm të cilësisë, akreditimit dhe proceseve të tjera, monitoron dhe vlerëson cilësinë e institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të ofruara prej tyre. Agjencia është krijuar me Vendim të KM nr. 303, datë 01.07.1999, “Për krijimin e sistemit të akreditimit në arsimin e lartë”² si Agjencia e Akreditimit, riorganizuar në Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë me VKM nr. 424, datë 02.06.2010 “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”³, i ndryshuar dhe së fundmi riorganizuar në Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 15.02.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë”⁴.

ASCAL ka si mision promovimin dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë bazuar në disa parime themelore si: (1) respektimin e autonomisë institucionale dhe lirisë akademike të institucioneve të arsimit të lartë; (2) transparencën dhe informimin në çdo hap të procesit; (3) mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë në IAL; (4) objektivizmin dhe profesionalizmin në të gjitha proceset e kryera prej saj si dhe (5) respektimin e kriterëve dhe standardeve shtetërore të cilësisë, të standardeve Europiane të cilësisë dhe standardet akademike në AL. Në veprimtarinë e saj për realizimin e këtij misioni, ASCAL gëzon

² VKM nr. 303, datë 01.07.1999, “Për krijimin e sistemit të akreditimit në arsimin e lartë”

³ VKM nr. 424, datë 02.06.2010 “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”

⁴ VKM nr. 109, datë 15.02.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë”

pavarësi në hartimin e procedurave të cilat publikohen dhe bëhen transparente për aktorët në fushën e arsimit të lartë.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të arsimit të lartë 80/2015⁵ dhe me riorganizimin në vitin 2017, profili i Agjencisë u fuqizua në drejtim të promovimit të cilësisë duke patur një bashkëpunëtor të ri që janë studentët, krahas bashkëpunimit të vazhdueshëm me IAL përmes proceseve të akreditimit dhe sigurimit të cilësisë.

1.2 BA, MISIONI, OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET KRYESORE

Pranë ASCAL është ngritur dhe funksionon Bordi i Akreditimit (BA), si organ kolegjal vendimmarrës dhe i pavarur në veprimtarinë e tij. Organizimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit të Akreditimit rrjedhin prej Ligjit 80/2015 dhe VKM nr. 109, datë 15.02.2017, “*Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë*”, duke patur pavarësi në funksionimin e tij si dhe kompetencën e vendimarrjes finale për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit që ato ofrojnë.

Përbërja dhe organizimi i Bordit të Akreditimit

Bordi i Akreditimit u riorganizua në vitin 2017 dhe përbëhet nga 11 anëtarë nga të cilët minimalisht 3 dhe maksimalisht 5 duhet të jenë të huaj. Të gjithë anëtarët janë personalitete të botës akademike me një eksperiencë të gjatë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë. Anëtarët dhe kryetari i Bordit emërohen dhe shkarkohen nga kryeministri me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin. Bordi i Akreditimit u emërua me urdhër të Kryeministrit Nr. 32, datë 17.03.2017 dhe organizoi mbledhjen e tij të parë në datën 07.04.2017.

BA është vazhdues i Këshillit të Akreditimit i krijuar në bazë të ligjit të arsimit të lartë Nr. 9741, datë 21.05.2007. Ligji i arsimit të lartë 80/2015, i jep fuqinë BA për të marrë vendimin përfundimtar mbi akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programve që ato ofrojnë. Në funksionet e veta, BA bashkëpunon me të gjitha institucionet që operojnë në fushën e arsimit të lartë, politikëbërjes dhe vendimarrjes duke dhënë rast pas rasti

⁵ Ligj Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”

rekomandime për sigurimin e cilësisë në fushën e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor. I gjithë aktiviteti i BA, përfshirë edhe ai financiar, mbështetet, sigurohet dhe drejtohet nga stafi i ASCAL.

1.3 ORGANIZIMI, BAZA LIGJORE E FUNKSIONIMIT TË ASCAL/BA

Përbërja, organizimi dhe funksionimi i ASCAL

Në bazë të vendimit të KM, nr. 424, datë 02.06.2010 "*Për miratimin e strukturës së Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë*", ASCAL është organizuar në tre sektorë dhe numri i punonjësve aktualisht është 15. Struktura organizative përbëhet nga Drejtori i ASCAL, Sektori i Promovimit dhe Vlerësimit të Cilësisë, Sektori i Statistikave dhe Analizave, Sektori i Shërbimeve dhe Publikimit. Çdo sektor drejtohet nga përgjegjësi përkatës. ASCAL ofron asistencën teknike për ekspertët e vlerësimit të jashtëm, Bordin e Akreditimit dhe bashkëpunëtorët e saj.

Fatkeqësisht, ASCAL ende funksionon me strukturën e APAAL e cila nuk është e përshtatshme për detyrat funksionale të ASCAL. Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme nuk ka qenë e mundur që struktura e re e ASCAL të aprovohet.

Baza ligjore e funksionimit të ASCAL/BA

Në Shqipëri, sistemi i akreditimit ka një eksperiencë disa vjeçare.

Disa nga dokumentet mbi të cilët bazohet aktiviteti dhe funksionimi i ASCAL/BA janë:

- Ligji Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*".
- Standardet shtetërore të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë (miratuar me Urdhëra të Ministrisë përgjegjëse (2011/2013)). Këto standarde përcaktojnë kriteret që duhet të plotësojnë institucionet e arsimit të lartë për hapjen/ licencimin e programeve të reja apo për akreditimin.
- Kodin e Cilësisë, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 11.09.2018.
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 15.02.2017, "*Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të*

Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë".

- Udhëzimet e Ministrisë Përgjegjëse për Arsimin e Lartë, të cilat koordinojnë mjaft nga procedurat e ASCAL, jo vetëm në kuadrin e vlerësimit por edhe për marrëdhëniet institucionale të ASCAL me institucionet e tjera dhe marrëdhëniet financiare të ASCAL me institucionet e arsimit të lartë dhe ekspertët.
- *“Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area”* (Standardet dhe udhëzimet të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë, ndryshuar në vitin 2015). Këto standarde janë reflektuar në dokumentet bazë të funksionimit të ASCAL si procedura të vlerësimit / akreditimit, etj.
- *“Rregulloren e Sistemit të Akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”*, e ndryshuar, etj.
- Manuali për procedurat e akreditimit të institucioneve dhe të programeve të studimit, miratuar në vitin 2015 dhe rishikuar në vitin 2017 si dhe aspekte dhe procedura të miratuara nga BA.

1.4 EKSPERTËT E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në ushtrimin e veprimtarisë së vlerësimit dhe akreditimit, ASCAL dhe BA bashkëpunojnë me ekspertë të jashtëm të vlerësimit dhe/apo konsulentë. Një arritje në kuadër të akreditimit të institucioneve dhe programeve të studimit, është përfshirja e ekspertëve të huaj në akreditimin e programeve të ciklit të dytë.

ASCAL dhe BA përditësojnë bazën e të dhënave të ekspertëve të vlerësimit dhe të konsulentëve, vendas apo të huaj, ku prioritet janë kualifikimet e duhura për llojin e vlerësimit që kryejnë, si dhe pavarësia për të dhënë një gjykim të drejtë dhe pa ndikime, duke shmangur çdo konflikt të mundshëm interesi. Ndër kriteret kryesore të përfshirjes së ekspertëve vendas apo të huaj në proceset e vlerësimit dhe akreditimit janë: kualifikimet e duhura për llojin e vlerësimit, pavarësia për të dhënë një gjykim të drejtë dhe pa ndikime, të jenë figura të njohura në fushën përkatëse të shkencës, të kenë përvojë prej të paktën 5 (pesë) vjetësh në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, të kenë të paktën gradën shkencore “Doktor”, të kenë përvojë në sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, të kenë integritet personal dhe profesional, të kenë përvojë ndërkombëtare të fituar përmes

studimeve pasuniversitare apo kualifikim shkencor në universitete a qendra kërkimore perëndimore.

Pas pranimit si ekspertë të vlerësimit, ata regjistrohen në sistemin e menaxhimit, pajisen me kredencialet përkatëse dhe me gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe cilësor të institucioneve për vlerësimin e të cilëve përzgjidhen. Për të gjithë procedurën, veprimtaria me dosjen e vetëvlerësimit dhe vizitat në vend, vlerësuesi harton raportin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë, të cilin e dorëzon për procedura të mëtejshme në ASCAL. Ekspertët mund të angazhohen nga ASCAL dhe BA për t'i ndihmuar me mendime dhe propozime për kriteret dhe metodat e vlerësimit, për rrugët dhe format e rritjes së cilësisë në arsimin e lartë, si dhe hartimin e dokumenteve që ndihmojnë procesin në tërësi.

KAPITULLI II

VEPRIMTARITË KRYESORE TË ASCAL GJATË VITIT 2018

2.1 PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT LIGJOR DHE PROCEDURIAL NË KUADËR TË PROCESEVE TË VLERËSIMIT

ASCAL, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, ka dhënë kontribut në përmirësimin e mëtejshëm të bazës ligjore që lidhet me arsimin e lartë dhe sigurimin e cilësisë. Specifikisht:

Në zbatim të Ligjit 80/2015, në shkurt 2018, është miratuar Rregullorja për funksionimin e brendshëm të Bordit të Akreditimit si dhe po punohet për përfundimin e Rregullores së re të brendshme të funksionimit të ASCAL. Këto janë akte të rëndësishme rregullative të funksionimit të brendshëm të dy institucioneve, të cilat reflektojnë një sërë ndryshimesh dhe atributesh që dalin nga ligji i arsimit të lartë.

Stafi i ASCAL, përfaqësuar nga drejtori, vazhdimisht propozon dhe jep mendime gjatë hartimit të akteve nënligjore dhe ka qënë pjesëmarrës në grupet e ngritura për hartimin dhe diskutimin e tyre. Angazhimi kryesor i ASCAL ka qënë në hartimin e standardeve shtetërorë të cilësisë në arsimin e lartë, në rishikimin dhe përmirësimin e dokumentit procedural në kuadër të proceseve të vlerësimit - *Manuali për procedurën dhe afatet për vlerësimin e cilësisë për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit* - i cili përcakton qartësisht hapat, procedurat, afatet kohore dhe përgjegjësitë e të gjithë faktorëve pjesëmarrës në një proces akreditimi institucional apo të programeve të studimit. Ky *Manual* është përgatitur nga ASCAL dhe miratuar nga Bordi i Akreditimit në vitin 2017, ndryshuar me Vendimin Nr. 71, datë 28.09.2018 të BA, për t'i dhënë mundësi IAL-ve për të dërguar komentet për Raportin përfundimtar të vlerësimit të jashtëm.

Disa nga aktet kryesore të brendshme të organizimit të punës së ASCAL / BA që janë rishikuar ose hartuar nga e para:

- Rregullore e brendshme e funksionimit të BA, miratuar nga Bordi i Akreditimit [VBA Ekstra Nr. 1, datë 02.02.2018];⁶
- Manuali për procedurat dhe afatet për vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit që ato ofrojnë, miratuar nga Bordi i Akreditimit [VBA Nr. 71, datë 28.09.2018];⁷
- Formatet / modelet e raportit të vlerësimit të brendshëm / jashtëm për akreditimin e programeve të studimit me karakter profesional, programet e ciklit të parë të studimeve “Bachelor”, programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, “Master i shkencave” dhe “Master i arteve”, si dhe për programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë;
- Formatet / modelet për kalendarin e aktiviteteve të akreditimit.

Gjatë vitit 2018, me pjesëmarrje të stafit të ASCAL në grupet e punës, janë përfunduar disa dokumente themelore të përcaktuara në Ligjin 80/2015:

- **Kodi i cilësisë** së arsimit të lartë, si përmbledhje e standardeve shtetërore për sigurimin e cilësisë, për programet e studimit me karakter profesional, programet e ciklit të parë të studimeve “Bachelor”, programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, “Master i shkencave” dhe “Master i arteve”, si dhe për programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, miratuar nga Këshilli i Ministrave [VKM Nr. 531, datë 11.09.2018];⁸
- “**Manuali për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet pyetësorit kombëtar të studentëve**”, miratuar nga Bordi i Akreditimit [VBA Ekstra Nr. 2, datë 30.03.2018]⁹, në të cilin janë përcaktuar fushat e vlerësimit, indikatorët dhe treguesit e matshëm si dhe spjegon në detaje metodologjinë që do të ndiqet për realizimin e Sondazhit Kombëtar të Studentë (SKS);

⁶ Rregullore e brendshme e funksionimit të BA, miratuar me VBA Ekstra Nr. 1, datë 02.02.2018

⁷ Ndryshim në “Manuali për procedurat dhe afatet për vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit që ato ofrojnë, miratuar me VBA Nr. 71, datë 28.09.2018

⁸ Kodi i cilësisë së arsimit të lartë, miratuar me VKM Nr. 531, datë 11.09.2018

⁹ “Manuali për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet pyetësorit kombëtar të studentëve”, miratuar me VBA Ekstra Nr. 2, datë 30.03.2018

- Është miratuar “*Pyetësoni për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve*” ku do të bazohet SKS si dhe “*Plan - veprimi për realizimin e SKS*” [VBA Nr. 45, datë 13.07.2018];¹⁰

Ndërkohë, disa grupe pune të ngritura nga Bordi i Akreditimit, për përgatitjen e dokumentacionit ligjor dhe procedural në kuadër të proceseve të vlerësimit dhe organizimit të punës së ASCAL:

- janë angazhuar në hartimin e standarteve shtetërore për sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë. Këto standarde përpara se të përcillen për miratim, janë diskutuar me institucionet e arsimit të lartë dhe ekspertët e vlerësimit;
- kanë marrë iniciativë për hartimin e Rregullores së brendshme të funksionimit të ASCAL dhe propozimin për strukturën e re të ASCAL që miratohet me urdhër të Kryeministrit.

¹⁰ “Plan - veprimi për realizimin e SKS”, miratuar me VBA Nr. 45, datë 13.07.2018

2.2 AKREDITIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË DHE I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit që ato ofrojnë, është aktiviteti kryesor i ASCAL në kuadër të vlerësimit të cilësisë në arsimin e lartë, duke u mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë dhe në standardet dhe udhëzimet përkatëse të cilësisë në Hapësirën Europiane dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Në bazë të Manualit 2017, procesi i akreditimit është i ndarë në faza:

Faza e aplikimit - shqyrtimi i aplikimeve

Institucionet e arsimit të lartë kryejnë aplikimet për akreditim nëpërmjet sistemit online të menaxhimit të ASCAL (ASCAL Management System – AMS) gjatë çdo viti akademik, në periudhën 1 Tetor – 31 Maj. Në vitin 2018, në ASCAL janë shqyrtuar **136 aplikime për akreditim**. Nga këto **3** kanë qënë aplikime për **akreditimin institucional** dhe **133** aplikime për **akreditim programesh** nga të gjitha llojet dhe ciklet e studimit.




Figura 1: Aplikime të shqyrtuara, 2018

Janë shqyrtuar aplikimet për akreditim institucional nga:

- 1 IAL publik (akreditim periodik)
- 2 IAL jopublike (akreditime periodike)

Kurse në aplikimet për akreditimin e programeve, për herë të parë kanë aplikuar për akreditimin e programeve të tyre, 2 institucione publike. Aplikimet e tjera kanë ardhur nga 15 IAL private.

Janë shqyrtuar gjithsej 133 aplikime për akreditim programesh:

- 17 aplikime nga 2 IAL publike
- 116 aplikime nga 15 IAL jopublike




Figura 2: Aplikime për akreditim programesh, 2018

Për sa i përket llojit dhe ciklit të këtyre aplikimeve, ato janë si më poshtë:

- 1 program studimi me karakter profesional (Diplomë Profesionale);
- 49 programe studimi të ciklit të parë (Bachelor);
- 6 programe studimi 4 vjeçare (Bachelor);
- 72 programe studimi të ciklit të dytë (25 Master profesional, 42 Master i shkencave, 5 program i integruar i studimeve të ciklit të dytë);
- 5 programe studimi të ciklit të tretë (4 Doktoratë, 1 Studim Specializues Afatgjatë).




Figura 3: Aplikime e programeve, 2018 (ciki/lloji)

Gjatë fazës së shqyrtimit të aplikimeve, janë kryer verifikimet për disa aspekte.

Në kuadër të aplikimeve për *akreditimin institucional*, verifikimet janë bazuar në:

- Ligjin 80/2015, datë 22.07.2015: Kreu III “Institucionet e arsimit të lartë”, Neni 17-29; Kreu V “Organizimi akademik dhe administrativ i institucioneve të arsimit të lartë, Neni 36-56;
- Udhëzimi i MASR Nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në Institucionet Publike të Arsimit të lartë”;
- VKM Nr. 539, datë 11.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë,” etj.;

Verifikimet janë përqëndruar në:

- shqyrtimin e akteve ligjore të themelimit, organizimit dhe funksionimit të IAL-ve;
- verifikim i të dhënave të përgjithshme të institucionit, si:
 - përmbushja e kërkesave ligjore të organizimit të institucionit;

- përmbushja e kërkesave ligjore të strukturës akademike;
- numri dhe shkalla e kualifikimit të stafit akademik, drejtuesve të IAL, njësisive bazë / kryesore;
- funksionimi i strukturave të sigurimit të cilësisë;
- numri i studentëve, programeve / fushave të studimit që ofron institucioni;
- verifikim mbi masat e marra nga Institucioni për përmbushjen e rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm (në rastet e akreditimit periodik - sikurse kanë qënë 3 aplikimet e shqyrtuara në vitin 2018).

Në aplikimet e shqyrtuara për akreditim institucional, janë hasur problematika në **2 prej tyre**, të cilat konsistojnë në mos-përmbushjen e kërkesave ligjore të strukturës akademike, mos-përmbushjen e kërkesave ligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të stafit akademik të njësisive bazë. Në këto raste, ASCAL i është drejtuar institucioneve të tjera, si: vetë IAL, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Bordit të Akreditimit, dhe vijon procesin pas reagimit të institucioneve kompetente në sqarimin e elementëve të identifikuar si problematikë.

Në kuadër të aplikimeve për *akreditimin e programeve të studimit*, verifikimet janë kryer në dy nivele:

- në nivel institucioni, sipas elementëve të mësipërm, duke patur në fokus dhe vlefshmërinë e akreditimit institucional;
- nivel programi për të cilin është aplikuar.

Baza ligjore e verifikimeve në nivel programi:

- Ligjin 80/2015, datë 22.07.2015: Kreu VII “Organizimi i studimeve në institucionet e arsimit të lartë”, Neni 69-73, 77, 79-84;
- VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”;
- VKM Nr. 539, datë 11.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë,” etj.;

Verifikimet janë përqëndruar në:

- shqyrtimin e akteve ligjore të hapjes, organizimit dhe funksionimit të programit të studimit;
- verifikim i të dhënave të përgjithshme të programit, si:

- përmbushjen e kërkesave ligjore të organizimit / strukturës së programit të studimit;
- përputhshmërinë e fushës e drejtimeve të IAL / njësisë kryesore / njësisë bazë me programin e studimit;
- përputhshmërinë e emërimit të programit të studimit me aktet që lidhen me organizimin / funksionimin e tij;
- numri dhe shkalla e kualifikimit të stafit akademik, të njësisë bazë / kryesore që ofron programin e studimit;
- numri i studentëve për programin e studimit;
- verifikim mbi masat e marra nga Institucioni për përmbushjen e rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm (në rastet e akreditimit periodik).

Në aplikimet e shqyrtuara për akreditimin e programeve, janë hasur problematika në **7 prej tyre**, të cilat konsistojnë në mos-përputhjen e organizimit të programit me licencimin, mos-përputhjen e emërimit të programit me licencimin, etj. Në këto raste, ASCAL i është drejtuar institucioneve të tjera, si; vetë IAL, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Bordit të Akreditimit, dhe vijon procesin pas reagimit të institucioneve kompetente në sqarimin e elementëve të identifikuar si problematikë.

Faza e aplikimeve është përmbyllur me miratimin e kërkesës dhe periudhës së vlerësimit, e cila më pas i është bërë me dije IAL sipas parashikimeve të Manualit 2017.

Faza e vlerësimit – vlerësimi i brendshëm (IAL), vlerësimi i jashtëm (ASCAL)

Dy faza të rëndësishme për proceset e akreditimit, institucional apo/dhe të programeve të studimit, janë vetëvlerësimi dhe vlerësimi i jashtëm.

Vetëvlerësimi përkundrejt standardeve shtetërore të cilësisë në arsimin e lartë, bazohet në përgatitjen e informacioneve dhe paraqitjen e të dhënave institucionale, hartimin e raporteve të vetëvlerësimit dhe të dokumentacionit mbështetës / verifikues të vlerësimit. Në këtë kuadër, institucionet kanë paraqitur dokumentacionet përkatëse që përbëjnë Dosjet e Vetëvlerësimit (DVV). Dokumentacioni i vetëvlerësimit është paraqitur në 2 gjuhë (shqip dhe anglisht) për proceset e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit të ciklit të dytë Master i shkencave, programeve të integruara të ciklit të dytë si dhe të programeve të ciklit të tretë të studimeve.

Me miratimin e Kodit të Cilësisë, në muajin Shtator 2018, të gjitha aplikimet për akreditimin e programeve të studimit të mbërritura në ASCAL nga 1 Tetori i këtij viti e në vazhdim, vlerësohen përkundrejt standardeve të miratuara në këtë Kod. Për këtë arsye, një pjesë e madhe e institucioneve të cilat kanë aplikuar për akreditimin e programeve me karakter profesional, programeve të ciklit të parë dhe programeve të ciklit të dytë, kanë kërkuar trajnimin e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, trajnim i cili iu është ofruar nga ASCAL. Kurse për proceset e tjera, kanë vijuar vlerësimet përkundrejt standardeve shtetërore të cilësisë të cilat janë në fuqi.

Efekte pozitive të procesit kanë qënë ndihma që kanë marrë IAL, veçanërisht IAL publike të cilat nuk i janë nënshtruar më parë një procesi të sigurimit të cilësisë, në grumbullimin, organizimin dhe sistemimin e dokumentacionit ekzistues në shërbim të një procesi të shëndetshëm për ta, e që mbetet e do të japë efekte afatgjatë në menaxhimin e përmirësimin e brendshëm të cilësisë.

Vlerësimi i jashtëm, është bazuar në analizën, vlerësimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe vlerësimin përmes vizitës në institucion. Grupet e vlerësimit të jashtëm, kanë vlerësuar dhe dakordësuar gjykimet pjesore e tërësore për të gjitha institucionet dhe programet e vlerësuara në mënyrë kolegjiale. Vlerësimi mbi bazë dokumentacioni është pasuar me vizitën në institucion dhe draftimin e raportit përfundimtar baur në komponentët e vlerësimit.

Grupet e vlerësimit kanë qëndruar në IAL përkatëse 2 ditë për çdo proces, ku kanë kryer takime sipas axhendave të parapërcaktuara dhe dërguar paraprakisht institucioneve. IAL-të kanë qënë bashkëpunuese gjatë këtyre proceseve, si me ekspertët e vlerësimit ashtu dhe me ASCAL në realizimin me përpikmëri të axhendave të takimeve.

Në përfundim, grupet e vlerësimit të jashtëm kanë hartuar draft-raportet e vlerësimit të cilat u janë dërguar institucioneve përkatëse për komente apo sqarime. Proceset janë përmbyllur me hartiminn e raportit përfundimtar të ekspertëve. Raproti i vlerësimit, përveç pjesës së vlerësimit përkundrejt standardeve, përcakton “gjetjet” e vlerësimit; në këto të fundit përfshihen pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë për përmirësime të mëtejshme, rreziqet për ruajtjen e cilësisë si dhe rekomandimet përkatëse.

Mbështetur në rezultatet e vlerësimit përkundrejt standardeve, ekspertët kanë dhënë gjykimet e tyre në lidhje me fushat e veçanta dhe kanë vlerësuar shkallën e përmbushjes ë Standardeve të Cilësisë sipas kategorive:

- *Nuk përmbushen;*

- *Përbushen pjesërisht;*
- *Përbushen kryesisht;*
- *Përbushen plotësisht.*

Në total janë zhvilluar **74 procedura akreditimi në vitin 2018**. Ndarja sipas kategorive dhe llojit të vlerësimit jepet në mënyrë të përmbledhur në tabelat e mëposhtme.

Tabela 1: Të dhëna për proceset e akreditimit institucional

AKREDITIM INSTITUCIONAL	
PUBLIK	1
PRIVAT	2
TOTAL	3
Lloji i vlerësimit	
Për herë të parë	-
Periodik	3
Total	3

Tabela 2: Të dhëna për proceset e akreditimit të programeve

AKREDITIMI I PROGRAMEVE	
PUBLIK	1
PRIVAT	70
TOTAL	71
Lloji i vlerësimit	
Për herë të parë	21
Periodik	50
Total	71

Tabela 3: Të dhëna për proceset e akreditimit sipas llojit të programeve

AKREDITIMI I PROGRAMEVE

Lloji i programit	Numri i vlerësimeve
Diplomë profesionale	4
Bachelor	16
Master profesional	20
Master i shkencave	30
Master i shkencave PIs	1
TOTAL	71




Figura 4: Proceset e akreditimit sipas llojit të programeve, 2018

Meqënëse procesi i vlerësimit zgjat në kohë, **101 procedura vlerësimi** do të jenë në proces zhvillimi dhe do të përfundojnë gjatë vitit 2019.

Rezultatet dhe vendimmarrja

Bazuar në Ligjin 80/2015 dhe VKM Nr. 109, datë 15.02.2017, Bordi i Akreditimi ka kompetencën e vendimmarrjes për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe

programeve të studimit që ato ofrojnë. Vendimi për akreditimin mund të jetë Pozitiv ose Negativ. Në rastin e një vendimi Pozitiv, BA shprehet dhe për kohëzgjatjen e akreditimit dhe mund të vendosë rekomandime për institucionet përkatëse në kuadër të përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë në arsimin e lartë.

Për sa më sipër, në vendimmarrjet e shqyrtuara gjatë vitit 2018 ka dhënë vlerësime Pozitive për institucionet dhe programet e studimit të vlerësuara.

Ndarja sipas kategorive dhe kohëzgjatjes së vlerësimit, jepet në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 4: Të dhëna për vendimmarrjen e akreditimeve sipas kohëzgjatjes

Vendimmarrja për:	Kohëzgjatja e akreditimit (vite)							
	1	2	3	4	5	6	Tjetër ¹¹	Total
Akreditim Institucional	-	1	1	1	-	-	-	3
Akreditim Programesh	1	3	4	7	41	12	3	71

Tabela 5: Të dhëna për vendimmarrjen e akreditimeve të programeve sipas kohëzgjatjes

Vendimmarrja për programet e studimit	Kohëzgjatja e akreditimit (vite)							
	1	2	3	4	5	6	Tjetër ¹²	Total
Akreditim DP	-	-	-	2	2	-	-	4
Akreditim Bsc	-	-	1	2	7	4	2	16
Akreditim MP	-	-	1	2	12	4	1	20
Akreditim Msc	1	3	2	1	19	4	-	30
Akreditim Msc PI	-	-	-	-	1	-	-	1
Total	1	3	4	7	41	12	3	71

¹¹ Në raste të veçanta, BA është shprehur për akreditimin e programeve të studimit për breza të caktuar të studentëve të regjistruar / diplomuar në to.

¹² Shiko shënim 11.

Rezultatet për akreditimin e programeve të studimit dhe institucionet e arsimit të lartë, Raportet e vlerësimit dhe Vendimet përkatëse të BA, janë publikuar në kohë reale në faqen zyrtare web të ASCAL (www.ascal.al).

Vendimmarrja e akreditimeve: programi përkundrejt kohëzgjatjes, 2018




Figura 5: Vendimmarrja e akreditimeve: programi përkundrejt kohëzgjatjes, 2018

Vendimmarrja e akreditimeve: kohëzgjatja përkundrejt programit, 2018




Figura 6: Vendimmarrja e akreditimeve: kohëzgjatja përkundrejt programit, 2018

2.3 LICENCIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Bazuar në Ligjin 80/2015, vlerësimi në kuadër të licencimit të programeve të reja të studimit, është kompetencë e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë. Prej fillimit të implementimit të ligjit të ri, si dhe deri në konsolidimin e njësisë përgjegjëse për këtë proces në MASR, Agjencia është angazhuar edhe për realizimin e këtij procesi. Gjatë vitit 2018, vlerësimet në kuadër të licencimit të programeve në 3 IAL publike dhe 4 IAL jopublike, kanë qënë të pakëta, krahasuar me vitet e tjera. Vendimet e fundit për hapjen e programeve të studimit janë marrë në mbledhjen e Bordit të Akreditimit, të muajit Maj.

Nga më sipër, nga **13 programe të vlerësuara**, **12** janë vlerësuar **pozitivisht** dhe **1 negativisht** duke rekomanduar rast pas rasti hapjen ose jo të këtyre programeve.

Tabela 6.1: Të dhëna për vlerësimet në kuadër të hapjes së programeve të studimit (Lloji i institucionit)

Vlerësimi në kuadër të hapjes së programeve të reja të studimit	
Institucioni	Numri i vlerësimeve
IAL publik	4
IAL privat	9
TOTAL	13

Tabela 6.2: Të dhëna për vlerësimet në kuadër të hapjes së programeve të studimit (Lloji i programit)

Vlerësimi në kuadër të hapjes së programeve të reja të studimit	
Lloji i programit	Numri i vlerësimeve
Bachelor	3
Master profesional	4
Master i shkencave	4
Studime specializuese afatgjata	1
TOTAL	13

2.4 SONDAZHI KOMBËTAR I STUDENTËVE

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 dhe VKM Nr. 109, datë 15.02.2017, një nga mekanizmat e sigurimit të jashtëm të cilësisë është edhe vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS). Kjo metodologji është e përhapur në mjaft vende dhe përdoret jo vetëm për këtë qëllim, por për të nxjerrë informacione të nevojshme për funksionimin e arsimit të lartë në tërësi apo aspekte të veçanta të operimit dhe funksionimit. SKS në asnjë rast nuk do të zvendësojë apo mbivendoset me procesin e akreditimit por synon mbledhjen e informacioneve të nevojshme nga janë studentët.

Objektivat kryesore të SKS janë:

- Të japë në mënyrë periodike informacione reale e të besueshme ASCAL, BA dhe MASR për cilësinë e arsimit të lartë bazuar tek mendimi dhe opinionin e studentëve;
- Të ndihmojë vendimarrjen dhe politikëbërjen në fushën e arsimit të me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë;
- Të ndihmojë vetë institucionet e arsimit të lartë të përmirësojnë funksionimin dhe të rrisin cilësinë e tyre;
- Të japë informacionet e nevojshme drejtuesëve të institucioneve, administratorëve etj, për hartimin e politikave të zhvillimit të institucioneve bazuar në nevojat dhe kërkesat e studentëve;
- Të informojë me të dhëna të besueshme, studentët aktualë me cilësinë e arsimit të lartë në institucionet kua ata studiojnë. Po ashtu synon të ndihmojë studentët e rinj me informacione për cilësinë e mësimdhënies në IAL dhe programet e studimit ku ata duan të studiojnë;
- Të informojë publikun për cilësinë e arsimit të lartë në Shqipëri.

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në bashkëpunim me Bordin e Akreditimit, bazuar në nenin Nr. 104 “Sigurimi i jashtëm i cilësisë”, të Ligjit 80/2015, në muajin Korrik 2017, filloi punën për zhvillimin e SKS. Fillimisht u ngrit një grup pune me përbërje nga ASCAL dhe BA, për analizën e pyetësorëve të zhvilluar në kuadër të akreditimit me QAA e më pas propozimet dhe përgatitjen e metodologjisë dhe përmbajtjes së sondazhit të studentëve, infrastrukturës / logjistikës, etj. Pas analizës, Grupi i Punës

përgatiti “Manualin për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve” dhe “Pyetësonin për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies”.

Manuali i përgatitur përmban në mënyrë të detajuar hapat, proceset, metodologjinë që përdoret në kuadër të SKS. Grupi i Punës përgatiti versionin parë të SKS në të cilin u përcaktuan fushat e vlerësimit, indikatorët dhe treguesit e matshëm. **Manuali** dhe **Pyetësoni** i përgatitur, u shqyrtuan dhe miratuan me Vendim të Bordit të Akreditimit, nr. ekstra 2, datë 30.03.2018.

Gjatë periudhës janar - prill 2018, ASCAL ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me IAL për nisjen e SKS.

Më muajin Shkurt 2018, janë njoftuar titullarët e institucioneve të AL publike dhe private, për zhvillimin e SKS dhe njëkohësisht u është kërkuar institucioneve të përgatisin listat e studentëve me kontaktet e tyre dhe t’i dërgonin ato në ASCAL. Kanë kthyer përgjigje me shkresë zyrtare për mbështetjen e zhvillimit të sondazhit vetëm 2 IAL, por që nga muaji Shkurt 2018 deri në muajin Maj 2018 kanë reaguar në përgjigje elektronike nëpërmjet sistemit AMS të gjitha IAL-të në lidhje me Sondazhin dhe kanë dërguar të dhënat e studentëve të tyre.

Gjithashtu, në muajin Mars 2018 është organizuar nga ASCAL dhe BA një takim informues me drejtuesit e Këshillave studentore, për t’i informuar rreth SKS dhe për të marrë mendimin e tyre. Më datë 13.07.2018, në Mbledhjen e BA u shqyrtuan dhe miratuan me Vendim të Bordit të Akreditimit, Nr. 45, “**Plan-Veprimi për realizimin e SKS**”. Procesi është ndërprerë në këtë fazë pasi gjatë kësaj periudhe, në institucionet publike janë zhvilluar zgjedhjet për ngritjen e Këshillave Studentore në përputhje me ligjin 80/2015. Meqenëse, bazuar në Manualin për zhvillimin e SKS, bashkëpunëtorët kryesorë të procesit janë studentët dhe strukturat e tyre, ky proces është konsideruar i pa mundur të zhvillohej deri në përfundim të riorganizimit të këtyre strukturave.

Gjatë vitit 2018, ASCAL dhe BA kanë qenë të angazhuar dhe në përgatitjen e gjithë infrastrukturës së nevojshme, setit të pyetjeve dhe versionit on line për shpërndarjen e pyetësorëve.

Plani fillestar i veprimtarive të parashikuar anë kuadër të këtij procesi janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Faza e zhvillimit të SKS në vitin 2018	Fillimi / Kohëzgjatja
1. Hartimi projekt i propozimit dhe miratimi nga BA	20 tetor – 30 tetor
	1 nëntor – 15 nëntor
	15 nëntor – 30 nëntor
2. Miratimi i procedurës së zhvillimit dhe pyetësorët e SKS	1 dhjetor – 15 dhjetor
	15 dhjetor – 30 janar
3. Shpërndarja e dhe plotësimi i pyetësorëve	1 shkurt – 25 shkurt
	1 mars – 30 mars
	1 prill – 30 prill
4. Mbledhja e të dhënave, filtrimi dhe përpunime statistikore, hartimi i databazës përmbledhëse	1 maj – 15 maj
	15 maj – 30 maj
5. Publikimi i nrezultateve paraprake në portalin on line	1 qershor - 30 qershor
	1 korrik – 30 korrik
6. Përgatitja e dokumentacionit për shqyrtim dhe vendimarrje në BA, publikimi i raportit final, përmbyllja e procesit	1 shtator – 1 nëntor
	1 nëntor – 30 nëntor
	dhjetor

Tabela 7: Plani fillestar i veprimtarive në kuadër të SKS

Plani i veprimit të SKS, u bë objekt i ndryshimeve pas miratimit të Kodit të Cilësisë dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 783, datë 26.12.2018 “Për vlerësimin e performancës në mësimdhënie të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë, edhe nëpërmjet sondazhit kombëtar të studentëve”.

KAPITULLI III

SISTEMI I RUAJTJES DHE ADMINISTRIMIT TË INFORMACIONIT DHE PROCEDURAVE NË ASCAL

3.1 SISTEMI I MENAXHIMIT TË INFORMATIONIT TË ASCAL: AMS

Një detyrë e rëndësishme që kryen ASCAL në kuadër të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë është monitorimi i ecurisë së proceseve të ndryshme me fokus sigurimin e cilësisë bazuar në mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave në kohë reale nga IAL-të. Aktualisht ASCAL disponon një nga platformat më të rëndësishme në vend në fushën e arsimit të lartë e cila përveç mbledhjes dhe ruajtjes së të dhënave mundëson kryerjen e disa procedurave / aktiviteteve kryesore në kuadrin e vlerësimit dhe akreditimit të institucioneve / programeve të arsimit të lartë si:

- Menaxhim të të gjitha procedurave të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit me ndërfaqe të dedikuar edhe në gjuhën angleze për shkak të angazhimit të ekspertëve ndërkombëtarë;
- Vlerësime të programeve / institucioneve në kuadrin e licencimit/hapjes së tyre;
- Vlerësime institucionale dhe programeve të reja në institucionet ekzistuese;
- Vlerësime në kuadrin e akreditimeve të reja dhe periodike në IAL;
- Analiza në arsimin e lartë të programeve dhe IAL-ve;
- Menaxhim të komunikimeve elektronike e postare;
- Menaxhim shërbimesh nga IAL, evoluim në kohë të proceseve në etapa të ndryshme;
- Informacion të besueshëm në kohe reale, menaxhim të proceseve të renditjes, klasifikimit e akreditimit, analiza, komunikim midis punonjësve;
- Menaxhim efektiv të detyrave, realizim i tyre në kohë;
- Komunikim me institucionet, komunikim me ekspertët;
- Realizimi i vlerësimit *on-line* për IAL dhe programe nga ekspertë vendas dhe të huaj si dhe vënia në dispozicion e mjaft dokumenteve e të dhëna *on-line* nga IAL;
- Plotësim të pyetësorëve dhe publikimi i rezultateve;

- Version “*mobile application*”, për AMS;
- Akses për përdoruesit (BA, IAL dhe ekspertët) i cili mundësohet nëpërmjet modulit *on-line* me mundësi aksesimi sipas hierarkisë dhe funksionit të përdoruesëve.

Gajtë procesit të akreditimit, operimi nëpërmjet AMS është efikas jo vetëm për faktin se arrihet komunikimi në kohë reale i të gjithë aktorëve të procesit, por se në këtë komunikim mundësohet dhe shkëmbimi i dokumentacioneve midis grupeve të punës në procedurat përkatëse.

Këto përditësime në AMS e kanë lehtësuar menaxhimin e proceseve të akreditimit pavarësisht sasisë së informacionit të administruar dhe specifikën e gjuhës angleze sipas rasteve kur në grupet e punës janë dhe ekspertë ndërkombëtarë. AMS në sondazhet e zhvilluara me IAL dhe ekspertët e vlerësimit, ka marrë vlerësimin maksimal për lehtësinë, efikasitetin, transparencën dhe mundësitë që ofron për proceset që menaxhohen nëpërmjet këtij sistemi.

3.2 ADMINISTRIMI I PROCESVEVE TË VLERËSIMIT NËPËRMJET AMS DHE MONITORIMI I CILËSISË

Në total, nëpërmjet AMS, ASCAL realizon 20 lloje procedurash të aktivitetit të përditshëm. Deri tani janë rreth **2460** shërbime/procese/procedura (akreditime, vlerësime, raportime, etj.) që janë menaxhuar apo në proces menaxhimi nga AMS. Në bazë të “*Manualit për procedurën dhe afatet për vlerësimin e cilësisë për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit*”, janë digjitalizuar të gjitha hapat që ndiqen në një procedurë vlerësimi për akreditimin institucional ose të programeve të studimit.

Nëpërmjet AMS, aktualisht për një procedurë akreditimi ndiqen hapat si vijon:

- Aplikimi për akreditim institucional gjatë çdo viti akademik, brenda periudhës 1 tetor – 31 maj por të paktën 1 vit para diplomimit të studentëve të parë për institucionet e reja apo përfundimit të akreditimit të parë ose akreditimit periodik. Koordinator i IAL ka kryer njëkohësisht aplikimin *on-line* nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të ASCAL (*ASCAL Management System – AMS*), në të cilin kanë akses të gjitha institucionet e arsimit të lartë. Në formularin e aplikimit, përveç të dhënave bazë të institucionit, IAL propozon edhe periudhën më të përshtatshme për IAL për kryerjen e akreditimit institucional. ASCAL dhe BA marrin në konsideratë ose jo periudhën e propozuar në varësi të agjendës vjetore të tyre dhe specifikave të IAL. E njëjta procedurë ndiqet edhe rastin e akreditimit periodik.
- ASCAL shqyrton paraprakisht përputhshmërinë ligjore të kërkesës së akreditimit dhe verifikon bazën ligjore të funksionimit të institucionit nga data e themelimit (për institucionet me akreditim të parë) dhe nga data e akreditimit paraardhës.

Kjo mundësohet nga AMS pasi i gjithë informacioni dhe dokumentacioni për çdo IAL tashmë është i regjistruar dhe lehtësisht i verifikueshëm. Disa nga proceset që menaxhohen nga AMS janë:

- Miratimi i periudhës së akreditimit nëpërmjet letrës të konfirmimit për fillimin e procesit të akreditimit duke përcaktuar periudhën e akreditimit (datën e fillimit dhe mbarimit të procesit). Në AMS specialisti i ASCAL përcakton planin e aktiviteteve me datat përkatëse për secilin prej tyre. IAL ndjek në kohë reale nëpërmjet llogarisë së vet ecurinë dhe realizimin e çdo faze të akreditimit.

- Vlerësimi i brendshëm nga GVB dhe IAL kryhet brenda 4 – 6 javëve, GVB dhe IAL përgatisin dosjen e akreditimit sipas listës së dokumentave të kërkuar nga ASCAL. Këto materiale ngarkohen edhe në formë elektronike në AMS.
- Gjatë periudhës së përgatitjes të dokumentacionit dhe hartimit të raporteve, ASCAL përgatit pyetësorët *on-line* për stafin akademik dhe studentët dhe i kontakton individualisht nëpërmjet *e-mail*-it duke u kërkuar plotësimin *on-line* të pyetësorëve respektivë. Në *e-mail* dërgohen gjithashtu të dhënat për aksesin e pyetësorëve (adresa dhe kodi personal). Formatet elektronike të pyetësorëve në versionet shqip dhe anglisht janë përgatitur nga ASCAL gjatë vitit 2015 (shih aneks 4)
- Vlerësimi i jashtëm është faza kryesore e procesit të akreditimit, e cila realizohet nga ASCAL:
 1. ngritja e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ),
 2. informimi i GVJ dhe vlerësimi i materialeve,
 3. vizita në IAL,
 4. raporti i vlerësimit të jashtëm dhe përgatitja e materialeve,

Në çdo hap të procesit të akreditimit, stafi i ASCAL është në kontakt të vazhdueshëm me kordinatorët e IAL duke shkëmbyer informacione dhe dokumente. Ndjekja në kohë reale e procesit, ndihmon të gjithë aktorët të koordinojnë me mirë aktivitetet duke fituar kohë dhe njëkohësisht duke rritur transparencën.

Një aspekt i rëndësishëm që IAL aplikojnë nëpërmjet AMS është portali i shërbimeve *on-line*. Nëpërmjet këtij portali, kordinatorët kërkojnë nga ASCAL fillimin e proceseve që lidhen me shërbimet që Agjencia apo BA ofron për institucionet e arsimit të lartë. Çdo aplikim për shërbim lidhet me një procedurë / proces të brendshëm të ASCAL dhe në këtë mënyrë IAL ndjek në kohë reale ecurinë e tij. Po ashtu, nëpërmjet AMS, kordinatori i IAL dërgon dhe merr informacione për çdo aspekt apo njoftim që vjen në adresë të IAL. Referuar të dhënave që ASCAL disponon, dhe nga deklarimi i IAL, Agjencia monitoron vazhdimisht cilësinë në IAL.

Në çdo fillim viti akademik, institucionet nëpërmjet kordinatorëve, japin informacion në AMS për stafin akademik për vitin akademik që pritet të fillojë, largimet dhe rekrutimet e mundshme, ndryshimet eventuale strukturore, programet aktive dhe jo aktive, studentët që ndjekin studimet për këtë vit akademik në çdo program studimi, etj. ASCAL bën krahasimet e të dhënave në përputhje me standartet dhe kriteret për sigurimin e cilësisë dhe

për disa institucione ka kërkuar informacione shtesë ose saktësim të dhënash. Analizat rast pas rasti janë dërguar titullarit të ASCAL dhe Bordit të Akreditimit.

Në ligjin e arsimit të lartë, monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë është një nga detyrat themelore të ASCAL. Për këtë arsye, të gjitha mekanizmat e ngritur nga ASCAL do të jenë mjaft të rëndësishme, edhe në të ardhmen, pasi mundësojnë ndjekjen dhe monitorimin në kohë reale të ecurisë së çdo institucioni të arsimit të lartë. Si rezultat i informacionit të mbledhur në vite, aktualisht stafi i ASCAL ka mundësuar krijimin e databazës më të madhe të arsimit të lartë në vendin tonë. Në këtë databazë, vetëm gjatë vitit të fundit janë hedhur për procesin e akreditimit institucional, janë administruar rreth 400 dokumente të ndara sipas llojit, kategorisë, gjuhës, etj.

Po ashtu nëpërmjet AMS, janë regjistruar një numër i madh komunikimesh ndërmjet ASCAL, BA, ekspertëve dhe IAL si dhe janë shkëmbyer mjaft dokumente shtesë ose informuese. I gjithë informacioni, i ruajtur në AMS, është lehtësisht i administrueshëm dhe i përdorshëm në funksion të çdo procesi /procedure dhe aktiviteti të ASCAL / BA por mund të shërbejë edhe për procese të ndryshme vlerësuese e analitike për aspekte të ndryshme në fushën e arsimit të lartë si p.sh kur në disa raste, BA ka ndërprerë procesin e vendimmarrjes deri në plotësimin e informacioneve të munguara.

3.3 INFORMIMI DHE PUBLIKIMI I INFORMACIONIT

Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, në funksion të transparencës dhe informimit të publikut ka qënë e fokusuar në implementimin metodave të reja (kryesisht teknologjisë) dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tyre. ASCAL ka aktualisht një sistem mjaft të konsoliduar për dhënien e informacionit dhe informimin e publikut.

Në përputhje me Neni 7 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për ASCAL i aksesueshëm për këdo në faqen zyrtare të institucionit. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së ASCAL / BA, nëpërmjet pasqyrit të detajuar në faqen zyrtare www.ascal.al. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste / përmbajtje, afate kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës të bërë publik, evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron *menu*-të ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument për informim dhe përdorim publik, i lëshuar nga ASCAL dhe BA, është i aksesueshëm edhe në versionin e plotë. Në këtë program transparence, ASCAL ka paraqitur mekanizmin dhe formën e dhënies së informacionit, si dhe kontaktet zyrtare për marrjen e informacionit elektronik. Referuar regjistrimit të dhënies së informacionit, **për vitin 2018**, ASCAL është përgjegjës zyrtarisht dhe ka dhënë informacion / dokumente, për **49 kërkesa** të regjistruara me numër rendor si dhe mbi **50 të tilla** të administruara në formë elektronike. Shpesh herë, këto kërkesa, të depozituara nga individë të ndryshëm, kanë patur të njëjtin objekt.

Pas riorganizimit të institucionit nga APAAL në ASCAL, Agjencia ndryshoi faqen zyrtare dhe njëkohësisht formën e paraqitjes së informacionit. Faqja zyrtare e ASCAL është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun në format lehtësisht të kuptueshëm. Dokumentacioni i bërë publik, është i përditësuar vazhdimisht në formë e përmbajtje. Faqja e ASCAL lexon të dhënat në kohë reale nga databaza e institucionit duke garantuar në këtë mënyrë përditësim të informacionit për publikun në kohë reale sapa merret një vendim, publikohet një raport apo zhvillohet një aktivitet.

Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve / subjekteve të të dhënave, etj.

Disa informacionet të rëndësishme të dhëna nëpërmjet faqes zyrtare janë:

- Dokumentacioni për vlerësimin dhe akreditimin me informacione të detajuara për çdo proces të zhvilluar nga çdo IAL, qoftë publik apo privat;
- Akte ligjore, dokumenti zyrtar për çdo IAL në lidhje me vlerësimin dhe akreditimin, si vendime të KA dhe BA, Urdhëra të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Raporte të vlerësimit të ekspertëve të jashtëm, etj.;
- Në faqen zyrtare janë të publikuara të gjitha këto dokumente në gjuhët shqip dhe anglisht. Po ashtu standardet shtetërore të cilësisë për të tre ciklet e studimit, janë në versionin elektronik dhe të printuar dhe u shpërndahen vazhdimisht IAL që janë në proces vlerësimi dhe akreditimi, raportet e vlerësimit në shqip dhe anglisht, etj.;
- Raporte vjetore, analitike të ASCAL dhe BA, etj.

Kërkesat për informacion ose dokumente kanë ardhur dhe janë administruar dhe nëpërmjet komunikimeve elektronike, si AMS, *e-mail*, etj. Stafi i ASCAL ka dhënë një numër të madh informacionesh nëpërmjet AMS (kryesisht për IAL, BA dhe ekspertët) dhe mjaft *e-mail*-e për publikun në tërësi, institucione vendase shtetërore apo private si dhe organizata të huaja me aktivitete në arsimin e lartë. Një pjesë e informacionit, është dhënë nëpërmjet raporteve informuese ose vjetore. Nëpërmjet faqes së ASCAL, përdoruesit mund të aksesojnë direkt sistemin e menaxhimit.

Gjithashtu në këto faqe ka dhe portale dhe module të tjera të dedikuara për dhënien e një informacioni sa më të qartë dhe të hollësishëm për publikun. Përparësia kryesore e këtij modeli, është komunikimi dhe ndërveprimi i publikut me faqen e internetit duke krijuar mundësinë e marrjes së informacionit të dëshiruar.

3.4 SISTEMI I RUAJTJES, ARKIVIMIT TË INFORMACIONIT DHE I SHËRBIMEVE NË ASCAL

Procesi për menaxhimin dhe administrimin e informacionit / dokumentacionit në ASCAL kryet nga arkiva / protokollin e institucionit. Çdo dokument ruhet në formë elektronike dhe të shkruar në arkivën dhe databazën e institucionit. ASCAL protokollon dhe ruan çdo dokument zyrtar në përputhje me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”. Në bazë të këtij ligji dhe të akteve të tjera të ruajtjes së informacionit zyrtar, ASCAL klasifikon informacionin sipas statusit të tij, *publik, përdorim të brendshëm, konfidencial, dhe sekret*. Po ashtu dhe aksesin e tij nga stafi i ASCAL, BA dhe ekspertët, bëhet në funksion të procesit / procedurës së cilës i përket dokumentacioni në fjalë. Aspekte të përdorimit të informacionit të brendshëm të ASCAL dhe mënyrës së dhënies së tij, janë përcaktuar në rregulloren e brendshme të ASCAL, të miratuar në vitin 2014.

Në funksion të proceseve të vlerësimit dhe akreditimit, tashmë, së bashku me dosjen e printuar, në ASCAL dorëzohet edhe versioni elektronik i saj.

Përsa i përket kapaciteteve logjistike dhe bazës materiale, ASCAL ka disa mangësi. **Infrastruktura dhe ambientet e punës, janë të vjetra dhe nuk i përmbushin standartet e një agjencie që aspiron të bëhet anëtare e ENQA.** Rrejtja e brendshme kompjuterike për stafin dhe anëtarët e BA është funksional por mjaft e amortizuar. Bordi i Akreditimit nuk ka një zyrë të posaçme ku të zhvillojë mbledhjet e veta, por në mungesë të saj mbledhjet e BA realohen në ambiente private që sjell kosto shtesë mbi financat e ASCAL. Në disa raste aktivitetet kryen në zyrën e titullarit të ASCAL ose me shumë vështirësi, në zyrat e tjera të Agjencisë. Pajisjet kompjuterike që i mundësojnë anëtarëve leximin e dosjeve në versionin elektronik apo hartimin e dokumenteve të tjera prej tyre, mungojnë. Çdo vit ASCAL, ka kërkuar përmirësimin e bazës materiale të ASCAL / BA dhe rikostruksioni i të gjitha ambienteve dhe mjediseve të punës së ASCAL. Gjithashtu, është e nevojshme ristrukturimi i sallës së mbledhjeve të Bordit të Akreditimit me parametrat normalë të punës, e cila të mundësojë gjithashtu dhe realizimin e mbledhjeve / takimeve *online* me anëtarët e huaj që s’janë prezent ose me ekspertët e huaj të vlerësimit. Vlerësimi i brendshëm që do të kryejë ASCAL në kuadrin e anëtarësimit në ENQA, është i fokusuar dhe në kapacitetet logjistike e financiare që zotëron agjencia, dhe si e tillë është një indikator mjaft i rëndësishëm për hapat e mëtejshëm të anëtarësimit në ENQA.

KAPITULLI IV

AKTIVITETE TË TJERA TË ZHVILLUARA NGA ASCAL DHE BA

4.1 AKTIVITETI I BORDIT TË AKREDITIMIT

Bordi i Akreditimit ushtron aktivitetin në ambiente të siguruara nga ASCAL. Mbledhjet e BA organizohen në bazë të një kalendari të hartuar në përputhje me numrin e aplikimeve që janë për t'u shqyrtuar. Në lidhje me aktivitetin kryesor të BA, disa nga veprimtaritë kryesore të zhvilluara gjatë vitit 2018, përmendim:

- *Hartimi dhe miratimi i akteve rregullatore të veprimtarisë së BA;*
- *Hartimi dhe miratimi i kritereve për ekspertët e vlerësimit të jashtëm;*
- *Shqyrtimi i aplikimeve dhe miratimi i listës së ekspertëve;*
- *Hartimi dhe miratimi i dokumentacionit të nevojshëm në kuadër të Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS);*
- *Organizimi i aktiviteteve në kuadër të proceseve të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë dhe Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS);*
- *Shqyrtimi dhe vendimmarrja përfundimtare në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit;*
- *Ndjekja e proceseve gjyqësore për ankimime të vendimeve në kuadër të akreditimit të programeve të studimit.*

Në zbatim të Ligjit 80/2015, në muajin Shkurt 2018, është miratuar “**Rregullorja e brendshme e funksionimit të Bordit të Akreditimit**”, me Vendim Nr. 1 të BA. Ky dokument është një nga aktet kryesore të brendshme të funksionimit të BA i cili është hartuar nga e para në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë në fuqi.

Gjatë këtij viti, BA ka zhvilluar veprimtarinë e tij, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e programeve të studimit dhe institucioneve të arsimit të lartë si dhe hapjes së programeve të reja të studimit. Në total gjatë vitit 2018, Bordi i Akreditimit zhvilloi 7 mbledhje dhe janë marrë 103 vendime në kuadër të licencimit, akreditimit, riorganizimit të IAL-ve apo programeve, etj. I gjithë aktiviteti pasqyrohet në tabelën 8:

MBLEDHJET E BA, 2018								
	2 Shkurt	30 Mars	11 Maj	13 Korrik	28 Shtator	27 Tetor	7 Dhjetor	Total
IAL Privat	9	7	8	26	20	12	9	91
IAL Publik	1	3	-	1	-	1	-	6
Tjetër	1	2	-	2	1	-	-	6
Total	11	12	8	29	21	13	9	103

Tabela 8: Aktiviteti i Bordit të Akreditimit, 2018

Një nga funksionet e tjera të Bordit të Akreditimit është miratimi i kritereve për pranimin e ekspertëve të vlerësimit dhe listës së ekspertëve për çdo vit, kjo listë pasi miratohet nga Bordi i Akreditimit regjistrohet në databazën e sistemit të ASCAL.

Në mbledhjen e muajit Mars është miratuar **lista e ekspertëve**, sipas Vendimit Nr. 3, kurse në mbledhjen e muajit Korrik, është miratuar dokumenti për “**Kriteret specifike dhe procedura e përzgjedhjes së ekspertëve vendas dhe të huaj të vlerësimit**”, sipas Vendimit Nr. 44 të Bordit të Akreditimit, për aplikimet dhe pranimet e reja për ekspertë në kuadër të proceseve të vlerësimit të jashtëm që kryen ASCAL për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.

Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, përveç mbledhjeve ka organizuar dhe ka qenë pjesëmarrës në aktivitete në kuadër të veprimtarive dhe detyrave që kryen ASCAL / BA, siç ishte takimi informues për përfundimin dhe rezultatet e akreditimeve institucionale me QAA, me institucionet e arsimit të lartë, me përfaqësues nga IAL publike dhe private dhe pjesëmarrjen e Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Ky aktivitet është zhvilluar zhvilluar më datë 2 Shkurt 2018.

Gjithashtu është organizuar nga ASCAL dhe BA një takim informimi me drejtuesit e Këshillave Studentorë më datë 30.03.2018, për t'i informuar dhe për të marrë mendimin e tyre për “Sondazhin Kombëtar të Studentëve”. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të

studentëve nga 25 Institucione të Arsimit të Lartë, publike dhe private. Pikat kryesore mbi të cilat u informuan përfaqësuesit e studentëve në këtë takim ishin: Qëllimi dhe fokusi kryesor i Sondazhit Kombëtar të Studentëve; Aktorët e procesit; Metodologjia dhe procedura e zhvillimit; Përmbajtja, fushat dhe indikatorët e vlerësimit; Analiza dhe rezultatet që priten. Si rezultat i këtyre aktivitetëve dhe diskutimeve mes ASCAL dhe BA, është miratuar në muajin Mars, “**Manuali dhe pyetësi për zhvillimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve**” dhe në muajin Korrik, “**Plan-Vepri për realizimin e SKS**”.

Përfaqësues të BA në disa raste kanë qënë pjesë e grupeve të punës me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve të vëna nga BA për institucione të ndryshme apo në kuadër të riorganizimi institucional.

Bordi i Akreditimit, në çdo aktivitet, ka mbështetjen financiare dhe logjistike të ASCAL. Një nga specialistët e agjencisë luan rolin e sekretariatit të BA, i cili kryen ndër të tjera këto funksione: përgatit agjendën e mbledhjeve dhe e propozon / kërkon aprovimin e anëtarëve, njofton anëtarët e Bordit të Akreditimit (për agjendën, në mbledhjen përkatëse dhe materialet që do të shqyrtohen etj.), përgatit dosjet dhe harton vendimet për programe / institucione private dhe programe / institucione publike, përgatit dosjet dhe harton vendime dhe dokumente të tjera zyrtare të BA, informon Bordin e Akreditimit me kërkesat e reja për akreditim, dërgon listat e ekspertëve, të propozuar nga Drejtori i ASCAL, komunikon në emër të BA me institucionet e tjera, regjistron minutat e mbledhjeve dhe e dërgon për miratim tek anëtarët e BA etj. I gjithë ky aktivitet dokumentohet dhe regjistrohet në AMS nëpërmjet procedurës “*Mbledhje të Bordit të Akreditimit*”. Anëtarët e BA, nëpërmjet llogarive në AMS kanë akses në të gjithë materialet dhe informacionet e vëna në dispozicion nga sekretariati i BA. Aktiviteti financiar i BA sigurohet nga ASCAL, nga të ardhurat e vlerësimit dhe akreditimit. Në këto shërbime përfshihen pagesat / honoraret për çdo pjesëmarrje, udhëtimet, akomodimi, etj.

4.2 BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË OSE TË TJERA NË VEND

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë ka kontakte të vazhdueshme me të gjitha institucionet që operojnë në fushën e arsimit të lartë si Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), Institucionet e Arsimit të Lartë në vend (IAL) dhe me aktorë të tjerë në fushën e arsimit të lartë si dhe institucione të tjera politikëbërëse në vendin tonë.

Bashkëpunimi me IAL në vend ka qënë i vazhdueshëm gjatë këtij viti, jo vetëm për shkak të realizimit proceseve të vlerësimit në kuadër të akreditimit, por edhe përgatitjes për zhvillimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve.

Përveç kontakteve të vazhdueshme, informimit për çdo dokumentacion apo ndryshime të reja, ASCAL ka kontakt të drejtpërdrejtë nëpërmjet AMS me koordinorët e çdo IAL. Çdo komunikim, informacion, dokumentacion, etj., bëhet në kohë reale dhe është i dokumentuar në sistemin e menaxhimit. ASCAL për shkak të ndryshimeve ligjore, në proceset e menaxhimit dhe administrimit të informacionit, vlerësimit dhe akreditimit, në hartimin e dokumenteve të reja, përveç komunikimit ka kryer disa takime / seminare informuese me koordinorët e institucioneve, drejtuesit e njësive të sigurimit të cilësisë si dhe me studentët.

Asistencë teknike dhe trajnime të vazhdueshme janë ofruar për njësitë e vlerësimit të brendshëm në IAL si dhe trajnime për hartimin raporteve të vlerësimit të brendshëm në përputhje me standardet e reja të cilësisë. Për vitin 2018, ASCAL ka kryer rreth **20 trajnime** të grupeve të vlerësimit të brendshëm për akreditimin institucional dhe të programeve dhe rreth **40 trajnime** individuale dhe të grupeve të ekspertëve të vlerësimit të jashtëm të angazhua në proceset e akreditimit.

Një nga aktivitetet më të rëndësishme të organizuara nga ASCAL gjatë vitit 2018, ishte seminari me temë: “*Standardet e Cilësisë për Programet e Ciklit të Parë, Ciklit të Dytë të Studimeve dhe Programeve me Karakter Profesional në Arsimin e Lartë: Reflektimi në Procesin e Vlerësimit të Cilësisë*”. Ky aktivitet u zhvillua në dy ditë:

22 Nëntor u zhvillua seminari me përfaqësues të Institucioneve të Arsimit të Lartë, publike dhe jopublike. Pikat kryesore të diskutimit në këtë takim u lidhën me: Standardet e reja të cilësisë për programet e ciklit të parë, ciklit të dytë të studimeve dhe programeve me karakter profesional në arsimin e lartë, që hynë në fuqi në shtator 2018; Ndryshimet eventuale dhe reflektimi i standardeve të reja, në metodologjinë dhe procesin e vlerësimit të cilësisë së këtyre programeve; Çështje të tjera procedurale apo dokumentacioni, që lidhen me reflektimin e standardeve të reja në procesin e vetëvlerësimit, vlerësimin e jashtëm dhe vendimmarrjes në kuadër të monitorimit dhe akreditimit të programeve;

23 Nëntor u zhvillua seminari trajnues me ekspertet e vlerësimit të jashtëm që angazhohen nga ASCAL. Ky trajnim kishte për qëllim prezantimin e standardeve të reja të cilësisë për programet e studimit të ciklit të parë, ciklit të dytë dhe programet me karakter profesional në arsimin e lartë, informimin dhe trajnimin mbi ndryshimet dhe reflektimin që do të kenë

standardet e reja të programeve të studimit në procesin, formatet e vlerësimit, procesin e vlerësimit të brendshëm e të jashtëm, dokumentacionin e vlerësimit dhe metodologjinë e vlerësimit dhe gjykimin nga ana e ekspertëve të vlerësimit.

Bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka qënë efikas gjatë kësaj periudhe. Stafi i ASCAL ka qënë pjesë e vazhdueshme e grupeve të punës në hartimin e drafteve të akteve nënligjore, të grupeve në kuadër të verifikimit të infrastrukturave pritëse të Universiteteve sipas kuotave të deklaruara të studentëve, etj. Po ashtu bashkëpunime ka patur në kuadër të njohjes së diplomave, programet e akredituara për Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe Qendrën e kërkimit shkencor, RASH, etj. Komunikim të vazhdueshëm ASCAL ka patur edhe me institucione të tjera, jo pjesë e arsimit të lartë si: Departamenti i Administratës Publike, Agjencia e Prokurimit Publik, etj.

4.3 BASHKËPUNIMI I ASCAL ME RRJETET NDËRKOMBËTARE TË AGJENCIVE TË SIGURIMIT TË CILËSISË

ASCAL, është anëtare me të drejta të plota në CEENQA Network, INQAAHE, dhe anëtare e asociuar e ENQA. Agjencia ka bashkëpunuar aktivisht me këto rrjete, ka marrë pjesë në disa nga veprimtaritë e organizuara prej tyre dhe veçanërisht në aktivitetet e organizuar nga ENQA. Fokus i veçantë i është kushtuar aktiviteteve që promovojnë cilësinë apo mekanizmat e sigurimit të cilësisë si dhe aktivitetet që sjellin të reja përsa i përket zhvillimeve në fushën e arsimit të lartë dhe sigurimit të cilësisë.

Në këtë kuadër, një aktivitet i rëndësishëm dhe që promovoi pozitivisht punën e ASCAL ka qënë organizimi nga ASCAL i aktivitetit të përvitshëm të Rrjetit të Agjencive të Europës Qëndrore dhe Lindore për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (CEENQA), “*Workshop dhe Asambleja e Përgjithshme e CEENQA, 2018*”, i zhvilluar në Tiranë në 11 – 12 Maj (<https://www.ceenqa.org/category/events/>). Në këtë aktivitet u paraqitën prezantime nga përfaqësues të agjencive të ndryshme, anëtare të rrjetit CEENQA.

Në vijim të aktiviteteve të organizuara nga CEENQA në Tiranë, u zhvillua në datën 12 Maj 2018 **Asambleja e Përgjithshme** (*General Assembly, 2018*) e kësaj organizate. Ndër diskutimet kryesore në këtë takim ishin ato mbi mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet agjencive të rrjetit; bashkëpunim për shkëmbimin e stafëve për procedurat e vlerësimit; si dhe bashkëpunim për ofrimin e internshipeve nga agjencitë me zhvillime inovative. Diskutime pati dhe mbi statusin / gjendjen aktuale të agjencive anëtare të rrjetit; mbi anëtarësime potenciale të agjencive të tjera të rajonit, mundësitë e zgjerimit të rrjetit. Gjithashtu u zgjodh presidenti i ri i CEENQA, me mandat 1 vjeçar dhe dy anëtarë të Bordit.

Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin 39 përfaqësues nga 21 organizata partnere nga 17 vende të Europës si dhe përfaqësues nga ENQA dhe EQAR. Me përfaqësuesin e ENQA u zhvillua një takim me fokus anëtarësimin e ASCAL në këtë organizatë, ku ASCAL mori këshilla për hapat e mëtejshëm në kuadër të këtij procesi. Mbi të gjitha, zhvillimi i këtij aktiviteti me përmasa Europiane, ka ndihmuar ASCAL të paraqitet denjësisht në mjaft evente të organizuara në fushën e arsimit të lartë dhe sigurimit të cilësisë në hapësirën Europiane të arsimit të lartë.

Gjatë aktiviteteve ku ka marrë pjesë, ASCAL ka prezantuar, paraqitur dhe informuar bashkëpunorët e saj për aktivitetet që kryen dhe angazhimet për anëtarësimin me të drejta të plota në ENQA dhe regjistrimin në EQAR. Përfundimet e nxjerra nga këto aktivitete

kanë qënë objekt diskutimi në ASCAL dhe janë reflektuar në aktivitetin e Agjencisë apo në aktet zyrtare të saj sikundër është reflektimi i disa ndryshimeve në procedurën e akreditimit bazuar në ESG 2015 dhe standardet shtetërore të cilësisë. Bashkëpunimi me institucionet partnere ka qënë i fokusuar edhe në propozimin e ekspertëve të vlerësimit apo për pjesëmarrje në projekte të përbashkëta.

Gjithashtu, ASCAL ka shprehur interes për bashkëpunim, propozimeve për pjesëmarrje në projekte të ndryshme të aplikuara nga institucione partnere. Të gjitha këto janë në fazën e aplikimit dhe në rast se shpallen fituese, ASCAL do të publikojë informacione të detajuara në faqen zyrtare të Internetit.

4.4 AKTIVITETI FINANCIAR I ASCAL DHE BA, 2018

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), sipas buxhetit të vitit 2018, kryen dhe mbështet të gjithë aktivitetin e vet financiar. ASCAL, në mbështetje të ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, Ligji 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, Udhëzimit Nr.2 datë 06.02.2012 të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, shkresat e Ministrisë së Financave Nr. 19433/45, datë 10.01.2018 “Dërgohet detajimi i shpenzimeve korente për vitin 2018”, kryen detajimin e buxhetit të miratuar në grupin e shpenzimeve korrente per vitin 2018, sipas klasifikimit buxhetor deri ne nivel artikulli.

ASCAL ka buxhetin e saj vjetor për vitin 2018 prej 23.603.000 lekë, fonde sipas zërave (paga art.600; sigurimet shoqërore art. 601; shpenzime operative, art. 602).

"Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

Periudha e Raportimit: 12 mujori viti 2018

Programi	09450			
Artikulli	Emertimi	Plani Viti 2018	Fakti Viti 2018	Realizuar %
600	Paga	15,603,000	12,485,692	80%
601	Sigurime Shoqërore	2,500,000	1,976,035	79%
602	Shpenzime operative	5,500,000	3,753,316	68%
	Totali	23,603,000	18,215,043	

Aktiviteti financiar i ASCAL bazohet në VKM 109 datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e

lartë”; shtojca 2, Tarifat për vlerësimin dhe akreditimin në institucionet e arsimit të lartë; Tabela 2/a Tarifat bazë për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin institucional të IAL-ve; Tabela 2/b Tarifat për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin e programeve të studimit;

Të ardhurat e arkëtuara nga shërbimet e realizuara nga ASCAL shpërndahen 10% në buxhetin e shtetit dhe 90% në buxhetin e Agjencisë. Pjesa e të ardhurave që i takon ASCAL, evidentohet, autorizohet dhe përdoret me strukturë të vecantë buxhetore kapitulli 6, “Të ardhura jashtë limitit”.

"Raporti i të ardhurave nga veprimtaria e saj"

Periudha e Raportimit: 12 mujori viti 2018

Viti	Të ardhura	Pjesa/ buxhetit	Pjesa/ASCAL	Të trashëguara	Totali	Shpenzime	Diferenca Ardhura- Shpenzime
2018	42,215,430	4,221,543	37,993,887	82,144,521	120,138,408	25,500,740	94,637,668
Totali	42,215,430	4,221,543	37,993,887	82,144,521	120,138,408	25,500,740	94,637,668

Në buxhetin e saj në fillim të vitit 2018 të ardhurat e trashëguara, janë 82,144,521 lekë.

ASCAL ka aktivizuar ekspertë të kualifikuar akademike për vlerësimin e programeve në arsimin e lartë.

I. Gjatë vitit 2018 janë kryer vlerësimet paraprake të programeve të studimit për të cilat janë kryer pagesat:

A. Për vlerësimin paraprak të programeve të studimit të ciklit të parë:

Janë vlerësuar me ekspertë programet :

a. Në Kolegjin Universitar “Logos”:

- Bsc.Studime në thelogjinë sociale dhe shkenca.religjoze",
- Bsc."Mësuesi për ars.parashkoll." ;
- Bsc. Gjuhë dhe civilizim grek

b. Në Universitetin “Aldent”

- Bsc."imazheri dhe radioterapi";

B.Për vlerësimin paraprak të programeve të studimit të ciklit të dytë:

a. Në Universitetin “Aldent”:

- Msc."Infermieri klinike" ;
- Msc.Int."Mjekësi e përgjithshme"
- Mp."Teknologjia dentare e avancuar”;

b. Në Universitetin “Marin Barleti”

- Msc."Psikologji shkollore dhe zhvillimi";
- Mp."Menaxhim i teknologjisë së informacionit"

c. Në Universitetin European i Tiranës

- Msc. “Shkenca Politike-Integrimi dhe Qeverisja”

d. Në Universitetin e Tiranës

- Msc. “Shkenca Politike-Integrimi dhe Qeverisja”

e. Në Akademinë e Sigurisë;

- Mp. 1 Vjekar "Rendi dhe siguria publike"
- Mp. 1 vjekar "Hetim krimi"

C. Për vlerësimin paraprak të programeve të studimit të ciklit të tretë:

a. Në Universitetin e Mjekësisë

- SPA "Kirurgji plastike, rikonstruktive dhe estetike"

II. Gjatë vitit 2018 janë kryer vlerësimet e jashtme për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit për të cilat janë kryer pagesat:

A. Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i programeve dy vjecare profesionale

a. Në Kolegjin Profesional të Tiranës

- Mekatronikë;

- Teknologji e informacionit dhe komunikimi
- Databazë dhe ëeb design;
- Gjeodezi;

B. Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të parë:

a. Në Universitetin “Albanian University”

- Bsc. “Inxhinieri kompjuterike”
- Bsc. “Inxhinieri elektronike”
- Bsc. “Inxhinieri elektrike”
- Bsc. “Teknologji informacioni”
- Bsc. “Menaxhim biznesi”

b. Në Universitetin “Aldent”

- Bsc. “Fizioterapi”

c. Në Institutin Kanadez të Teknologjisë

- Bsc. “Inxhinieri industriale”

d. Në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë

- Bsc. “Shkenca ekonomike” me profile
- Bsc. “Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci”
- Bsc. “Shkenca politike dhe administrative”

e. Në Kolegjin Universitetin Eësdom

- Bsc. “Financë-bankë”

f. Në Universitetin e New York-ut

- Bsc. “Administrim biznesi”
- Bsc. “Sistemet e informacionit”

g. Në Kolegjin Universitar i Biznesit

- Bsc. “Ekonomi”
- Bsc. “Drejtësi”
- Bsc. “E drejtë biznesi”

C .Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë:

a. Në Universitetin “Marin Barleti”

- Mp. “Mësuesi në edukim fizik dhe sporte”
- Mp. 1 vjekar “Administrim biznesi” me profile
- Mp. 1 vjekar “Shkenca politike” me profile

b. Në Universitetin”Polis”

- Msc. Inxhinieri ndërtimi” me profile: Strukturë;Gjeoteknikë;

c. Në universitetin European të Tiranës

- Msc. “Administrim biznesi” me profile
- Mp. 1 vjekar “Financë” me profile
- Msc. “Financë-bankë” me profile
- Msc. “ E drejtë private dhe biznesi” me profile
- Msc. “Komunikim dhe marrëdhënie publike” me profile
- Mp. 1 vjekar “Marrëdhënie publike” me profile
- Msc. “Shkenca politike” me profile
- Msc. “Marrëdhënie ndërkombëtare” me profile
- Msc. E drejte publike dhe ndërkombëtare” me profile
- Mp. 1 vjekar “Menaxhim biznesi” me profile
- Mp. 1 vjekar “Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci” me profile
- Mp. 1 vjekar “Shkenca politike” me profile
- Mp. 1 vjekar “Drejtësi” me profile
- Mp. 1 vjekar “Marketing” me profile

d. Në Universitetin “Aldent”

- Msc. “Fizioterapi klinike”

e. Në Kolegjin Universitar “Logos”

- Mp. 1 vjekar “Teknikë e lartë në laboratorët mjekësorë
- Mp. 1 vjekar “Financë-kontabilitet”

ë. Në Universitetin e Sporteve

- Mp. 1 vjekar “Menaxhim në sport dhe turizëm”

f. Në Universitetin “Epoka”

- Mp. 1 vjekar “Inxhinieri ndërtimi”
- Mp. 1 vjekar “Inxhinieri kompjuterike”
- Msc. “Inxhinieri kompjuterike”
- Mp. 1 vjekar “Administrim biznesi”
- Msc. “Administrim biznesi”
- Mp. 1 vjekar “Shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare”
- Msc. “Shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare”
- Mp. 1 vjekar “Financ-bankë”
- Msc. “Financë-bankë”
- Msc. “Arkitekturë”
- Msc. integruar “Arkitekturë”
- Msc. “Inxhinieri ndërtimi” me profile

g. Në Universitetin “Mesdhetar të Shqipërisë”

- Mp. 1 vjekar “Menaxhim biznesi”
- Msc. “Financë-bankë”
- Mp. 1 vjekar “Marrëdhënie ndërkombëtare” me profile
- Mp. 1 vjekar “Sistemet e informacionit në biznes”
- Msc. “Sistemet e Informacionit në Biznes”
- Mp. 1 vjekar “Shkenca politike dhe administrative”
- Msc. “Psikologji”
- Msc. “Marrëdhënie ndërkombëtare”
- Msc. “Shkenca politike”
- Msc. “Inxhinieri ndërtimi” me profile

h. Në Kolegjin Universitar i Biznesit

- Msc. “E drejtë penale”
- Msc. “E drejtë civile dhe tregtare”

i. Në Kolegjin Universitar Wisdom

- Msc. “Psikologji shkollorë”

j. Në Albanian University

- Msc. “Teknologji informacioni”
- Msc. “Inxhinieri elektronike”
- Msc. “Administrim biznesi”
- Msc. “Psikologji klinike”
- Msc. “Menaxhim bankar”

k. Në Universitetin e New York-ut

- Msc. “E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare”
- Msc. “Shkenca kompjuterike”
- Msc. “Çështje (marrëdhënie) ndërkombëtare”

Ç. Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë me ekspertë të huaj:

Në Universitetin Europian të Tiranës

- Msc. “E drejtë publike dhe ndërkombëtare” me profile

Në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë

- Msc. “Sistemet e informacionit në biznes”
- Msc. “Marrëdhëniet ndërkombëtare”

Në Universitetin “Polis”

- Msc. “Inxhinieri ndërtimi” me profile

Në Universitetin “Epoka”

- Msc. integruar “Arkitekturë”
- Msc. “Arkitekturë”
- Msc. “Inxhinieri ndërtimi”
- Msc. “Shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare”
- Msc. “Shkenca kompjuterike”

Në Universitetin “New York”

- Msc. Çështje (Marrëdhënie) ndërkombëtare”
- Msc. “Shkenca kompjuterike”
- Msc. “ E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare”

D .Vlerësimi i jashtëm institucional me ekspertë vendas dhe të huaj:

- “Kolegji Universitar Qiriazi”
- Universiteti i Tiranës

ASCAL ka paguar tarifat e anëtarësimit në organizmat ndërkombëtare (ENQA; CEENQA dhe INQAAHE).

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) ka qënë partnere në projektin Erasmus + “Strategic support on strengthening the quality assurance structures at the private higher education institutions in Albania-QAinAL”, me ftesë të Universitetit të Salzburgut, Austri. Roli dhe përgjegjësitë kryesore të ASCAL kanë qënë në funksionin e një këshilluesi të jashtëm, duke dhënë në çdo kohë mbështetjen e kërkuar nga institucionet e përfshira në projekt. Projekti ka perfunduar duke mbyllur të gjitha detyrimet finaciare përkundrejt grandit të akonduar për partnerin ASCAL.

KAPITULLI V

PLANI I VEPRIMTARIVE PËR VITIN 2019

Plani i aktiviteteve për vitin 2019, është pjesë e planit të ndryshimeve të mëdha që lindin nga implementimi i ligjit të arsimit të lartë. Ky plan afatshkurtër, fokusohet në dy drejtime kryesore: riorganizimi strukturor i ASCAL si institucioni që menaxhon aktivitetet për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe vazhdimësia e proceseve të vlerësimit dhe akreditimit. ASCAL përveç synimit kryesor, rritjen e cilësisë në arsimin e lartë, synon sipas një plani afatmesëm, të anëtarësohet me të drejta të plota në Rrjetin Europian të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë (ENQA) dhe regjistrohet në Regjistrin Europian të Agjencive (EQAR).

Referuar planit një vjeçar, për vitin 2019, ASCAL / BA parashikon të zhvillojë aktivitetet si më poshtë:

1. *Finalizimin e procesit të riorganizimit bazuar në miratimin e strukturës së ASCAL.* Riorganizimi i ASCAL është procesi më i rëndësishëm dhe kompleks që sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015, duhet të përfundojë brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e tij. Edhe pse një pjesë e proceseve në funksion të riorganizimit kanë filluar ose janë në vazhdim prej 2015, në këtë drejtim në vitin 2019 parashikohet të:
 - Hartohet draft Vendimi i Këshillit të Ministrave së bashku me relacionin shpjegues për organizimin dhe funksionet e ASCAL.
 - Hartohet draft Vendimi i Këshillit të Ministrave së bashku me relacionin shpjegues për organizimin dhe funksionet e Bordit të Akreditimit.
 - Hartohet draft rregullorja e jashtme për sigurimin e cilësisë së bashku me relacionin shpjegues.
 - Miratojë strukturën organizative dhe rregulloret e brendshme të ASCAL dhe BA. Riorganizimi i brendshëm i ASCAL në përputhje me aktet e miratimit.
 - Kontribuojë në hartimin e akteve nënligjore të implementimit të ligjit të arsimit të lartë së bashku me grupi e ekspertëve që do të angazhohen për këtë proces.

2. *Zhvillimi i procedurave të vlerësimit në kuadër të akreditimit të institucioneve dhe programeve.*

PLANI I PUNËS NË SEKTORIN E SPVC / ASCAL VITI 2019
1. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë për akreditimin e parë dhe periodik të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit.
2. Vlerësimin e sistemeve të brendshme të cilësisë në IAL-të; përgatitja dhe miratimi i udhëzuesit për Ngritjen dhe funksionimin e NJSBSC në IAL.
3. Mbështetja e veprimtarisë së Bordit të Akreditimit.
4. Bashkëpunimi me MASR për arsimin për përgatitjen e standardeve shtetërore të cilësisë dhe përditësimin në vijim të tyre si pjesë e Kodit të Cilësisë.
5. Aktivitete në bashkëpunim me sektorë të tjerë.

Në këtë kuadër ASCAL parashikon të përfundojë të gjitha procedurat që janë në proces / që vazhdojnë sipas skedulimeve nga viti 2018, apo aplikimet e reja që vijnë në fillim të 2019, në përputhje me Manualin e miratuar në vitin 2017. Në këtë drejtim për vitin 2019 parashikohet të:

- Regjistrohen aplikimet për akreditim në përputhje me procedurën e akreditimit për vitin akademik 2018 – 2019;
- Përfundojnë procedurat e akreditimit për 1 program studimi dy vjeçar, me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, që është skeduar ose / dhe në proces akreditimi nga viti 2018;
- Përfundojnë procedurat e akreditimit për 43 programe të ciklit të parë, të skeduluara ose / dhe në proces akreditimi nga viti 2018;
- Përfundojnë procedurat e akreditimit për 44 programe të ciklit të dytë, të skeduluara ose / dhe në proces akreditimi nga viti 2018;

- Përfundojnë procedurat e akreditimit për 5 programe të ciklit të tretë, të skeduluara ose / dhe në proces akreditimi nga viti 2018;
 - Përfundojnë procedurat e akreditimit për 3 IAL (*private*) të skeduluara gjatë vitit 2018.
3. Realizimi i *Sondazhit Kombëtar të Studentëve*, për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, në të gjitha IAL publike dhe private (*për herë të parë*).
 4. *Asistencë teknike për BA dhe ekspertët e vlerësimit.*

Në planin e veprimtarive në kuadrin e akreditimit, ASCAL do të ofrojë asistencë teknike dhe financiare për Bordin e Akreditimit dhe ekspertët e vlerësimit të jashtëm. Në këtë kuadër, në përputhje me procedurën e akreditimit 2017, ASCAL do të ofrojë të gjithë materialet e nevojshme (DPA – Dosjet e plota të akreditimit) në funksion të anëtarëve të BA dhe ekspertëve. Në lidhje me përditësimin e regjistrit të ekspertëve, fillim të vitit 2019, do të bëhet shpallja e njoftimit për aplikim për ekspertë vendas dhe të huaj. I njëjti njoftim publik që publikohet në faqen zyrtare të ASCAL, do t’ju dërgohet edhe rrjeteve europiane ku ASCAL është partnere.
 5. *Bashkëpunimin me institucionet e arsimit të lartë* në kuadër të reformës dhe implementimit të ligjit të arsimit të lartë me fokus të veçantë riorganizimin e njësive të brendshme të sigurimit të cilësisë në përputhje me këtë ligj.
 6. Një nga synimet kryesore për vitin 2019, është *rikostruksioni tërësor i ambienteve të ASCAL / BA*. Agjencia ka kërkuar mbështetjen financiare për realizimin e këtij synimi.
 7. Në kuadrin e përmirësimit të funksionimit dhe procedurave, ASCAL do të vazhdojë *marrjen e mendimeve nga ekspertët e huaj të vlerësimit të jashtëm* me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të procedurave me të cilat ASCAL do të funksionojë.
 8. Synohet *pjesëmarrja në të gjithë aktivitetet dhe eventet e organizuara nga partnerët dhe bashkëpuntorët tanë*. ASCAL do të synojë financimin me fonde, kryesisht nga projektet e Komisionit Europian, të ndryshme me qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e treguesve të performancës pas riorganizimit dhe ristrukturimit të saj, si kundër janë Twinning, Taiex, Erasmus +, etj.